



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III
Komisioni për Integritet Evropian
Mbledhja nr. 60
Prishtinë, më 09. 07. 2010, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala C-203

PROCESVERBAL
I mbledhjes së Komisionit për Integritet Evropian

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Džezair Murati, Fatmir Rexhepi, Arsim Bajrami, Nait Hasani dhe Naser Rugova.

Munguan: Njomza Emini, Petar Miletqi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli dhe Safet Beqiri.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Shqyrtimi i projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE,**
- 2. Shqyrtimi i projektligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE,**
- 3. Shqyrtimi i projektligjit për administratën tatimore dhe procedurat, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE,**
- 4. Shqyrtimi i projektligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE,**
- 5. Shqyrtimi i projektligjit për Gjykatat, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE,**
- 6. Shqyrtimi i projektligjit për vlersimin e ndikimit në mjedis, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE.**

Kryesuesja konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen.

1. Shqyrtimi i projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE.

Kryesuesja tha e kemi thirrur këtë mbledhje sepse këto projektligje janë radhitur për në seancën e radhës dhe duhet dhënë rekomandimi i Komisionit.

Shtoi se projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë mund të procedohet tutje sepse nuk i cenon parimet e *acquis communautaire*.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni një zëri nxori këtë

Përfundim

Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, me amendamentet e Komisionit funksional është në harmoni me *acquis communautaire*.

2. Shqyrtimi i projektligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE.

Kryesuesja, ftoi deputetin Naser Rugova-referues i këtij projektligji të paraqet Raportin për këtë projektligj.

Naser Rugova - Ky projektligj me amendamentet e komisionit funksional mund të procedohet më tutje, sepse nuk i cenon parimet e *acquis communautaire*.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, me amendamentet e Komisionit funksional është në harmoni me *acquis communautaire*.

3. Shqyrtimi i projektligjit për administratën tatimore dhe procedurat, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE.

Kryesuesja, ftoi deputetin Arsim Bajrami-referues i këtij projektligji të paraqet Raportin për këtë projektligj.

Arsim Bajrami - Ky projektligj me amendamentet e komisionit funksional mund të procedohet më tutje, sepse nuk i cenon parimet e *acquis communautaire*.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji për administratën tatimore dhe procedurat, me amendamentet e Komisionit funksional është në harmoni me *acquis communautaire*.

4. Shqyrtimi i projektligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE.

Kryesuesja, ftoi deputetin Dzezair Murati-referues i këtij projektligji të paraqet Raportin për këtë projektligj.

Dzezair Murati - Ky projektligj me amendamentet e komisionit funksional mund të procedohet më tutje, sepse kjo fushë rregullohet me legjislacion nacional.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional rregullohet me legjislacion nacional.

5. Shqyrtimi i projektligjit për Gjykatat, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE.

Kryesuesja referuese e këtij projektligji tha ky projektligj me amendamentet e Komisionit funksional mund të procedohet tutje sepse kjo fushë rregullohet me legjislacion nacional.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni një zëri nxori këtë

Përfundim

Projektligji për Gjykatat, me amendamentet e Komisionit funksional rregullohet me legjislacion nacional.

6. Shqyrtimi i projektligjit për vlersimin e ndikimit në mjedis, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE.

Kryesuesja, ftoi deputetin Naser Rugova-referues i këtij projektligji të paraqet Raportin për këtë projektligj.

Naser Rugova - Ky projektligj me amendamentet e Komisionit funksional mund të procedohet më tutje, sepse nuk i cenon parimet e *acquis communitaire*.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis, me amendamentet e Komisionit funksional është në harmoni me acquin communitaire.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Zylfije Hundozi